



## **Bashkësia e Interesit për Mbështetjen e Gjuhëve të Para**

Qëllimet dhe aktivitetet e Bashkësisë së Interesit për Mbështetjen e Gjuhëve të Para

Qëllimet e Bashkësisë së Interesit

Bashkësia e Interesit për Mbështetjen e Gjuhëve të Para angazhohet që përkrahja e gjuhëve të para të fëmijëve, posaçërisht edhe të fëmijëve të familjeve migrante, të jetë një detyrë qendrore e arsimit publik, të merret parasysh dhe të sanksionohet me ligj.

Anëtarësia

Kësaj Bashkësie i përkasin organizatat, shoqatat dhe personat të cilët për arsye pedagogjike dhe didaktike, por edhe për arsye arsimore, gjuhësore dhe për arsye të politikës së integrimit angazhohen për qëllimet e Bashkësisë së Interesit. Bazë për anëtarësim është nënshkrimi i thirrjes “Gjuhët e para të fëmijëve të përkrahen- një detyrë qendrore e arsimit publik” përmes organizatave, shoqatave dhe personave veç e veç.

Qëllimet

- Thirrja merr një përkrahje të gjerë nga qarqet e interesuara dhe është e njohur për publikun.
- Qëllimet, kërkesat dhe arsyetimet e BI janë të njohura te publiku i gjerë.
- Përkrahja e gjuhëve të para të fëmijëve në fushën e arsimit zviceran qëndron në agjendën politike të bartësve të vendimeve në federatë, kantone dhe komuna.
- Kërkesat e BI njihen dhe futen në përdorim hap pas hapi.



## Aktivitetet konkrete

- Përktimi i thirrjes, i cili u miratua në mbledhjen e formimit të BI më 22.9.2007, në gjuhët e vendit dhe në gjuhët më të rëndësishme për nga numri i bashkësive migrante në Zvicër.
- Mbledhja e nënshkrimeve nga organizatat, shoqatat dhe personat veç e veç nga fusha e shkencës dhe kërkimeve shkencore nën thirrjen “Gjuhët e para të fëmijëve të përkrahen – një detyrë qendrore e arsimit publik”.
- Konferenca nacionale për media dhe punë me media në shumë gjuhë, që puna e BI të lancohet në publik dhe të bëhen të njohura qëllimet dhe kërkesat e saj.
- Koordinim i punës së lobimit për përmbajtjet e thirrjes tek konferenca e drejtorëve të edukimit, federata, drejtoritë kantonale të arsimit, komunat dhe qytetet, shkollat e larta pedagogjike dhe adresat e tjera për kërkesat e thirrjes në politikë, shoqëri dhe publik.
- Krijimi i një faqeje projekti vetanak interneti me materiale të ndryshme dhe vegza, posaqërisht për organizatat anëtare të BI.
- Shkrimi i raporteve mbi aktivitetet gjegjësisht marrja e materialeve nga organet e shtypit të organizatave dhe shoqatave.

## Organizimi i punës dhe financat

BI formon një grup udhëheqës pune, i cili është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve. Ky grup organizohet vetë dhe përcakton personat të cilët e përfaqësojnë BI jashtë. Sipas nevojës ky grup thërret anëtarët e BI për mbledhjet, posaqërisht para marrjes së vendimeve, të cilat e kalojnë thirrjen ose kërkojnë ndryshime ose zgjerime të saj.

Organizatat anëtare ose personat veç e veç marrin përsipër me vetëdashje dhe sipas mundësive punët koordinative për BI. Për këtë VPOD, Projekti Arsimi Interkulturore, vë nën këto kondita në dispozicion kapacitetet e sekretariatit.

Organizatat anëtare do të luten për kontribute financiare në rast nevojë.

Plotësuar dhe miratuar në mbledhjen e formimit të Bashkësisë së Interesit për Mbështetjen e Gjuhëve të Para, më 22 shtator 2007